

Indeksi i Kushtimit në Ndërtim për Banesa


Tremujori IV, 2025

Tiranë, më 04 Mars 2026: Indeksi i Kushtimit në Ndërtim, në tremujorin e katërt 2025 arriti 114,1 kundrejt tremujorit të katërt 2021 si periudha bazë. Ndryshimi vjetor i Indeksit të Kushtimit në Ndërtim në tremujorin e katërt 2025 është 1,2 %, i njëjtë me ndryshimin vjetor të regjistruar në të njëjtin tremujor të vitit paraardhës.

Ndryshimet vjetore të grupeve kryesore: Krahasuar me të njëjtin tremujor të një viti më parë, rritja më e madhe e çmimeve vërehet në grupin “Shpenzime për paga” me 6,0 %, pasuar nga grupi “Shpenzime makinerie” dhe “Kosto të tjera” përkatësisht me 1,8 % secili dhe “Shpenzime transporti” me 1,6 %. Nga ana tjetër grupi “Shpenzime materiale” shënoi ulje me 0,9 %.

Brenda grupit “Shpenzime materiale”, indeksi i nëngrupit “Materiale ndërtimi” shënoi ulje me 1,1 %, pasuar nga dhe nëngrupi “Materiale hidro-sanitare dhe ventilimi” me 0,6 % dhe nga nën grupi “Materiale elektrike dhe komunikimi” me 0,1 %.

Fig. 1 Ndryshimet vjetore të Indeksit të Kushtimit në Ndërtim për Banesa



Ndryshimet tremujore të grupeve kryesore: Indeksi i Kushtimit në Ndërtim shënoi rritje me 0,1 %, krahasuar me tremujorin e tretë të vitit 2025. Rritja më e madhe e çmimeve vërehet në grupin “Shpenzime për paga” me 1,4%, pasuar nga grupet “Shpenzime makinerie” dhe “Kosto të tjera” përkatësisht me 0,3 % secili dhe “Shpenzime transporti” me 0,1 %. Nga ana tjetër, grupi “Shpenzime materiale” ka shënuar ulje me 0,5 %. Brenda këtij grupi, ulje pati nëngrupi “Materiale ndërtimi” me 0,6 %, pasuar nga nëngrupi “Materiale hidro-sanitare dhe ventilimi” me 0,5 % dhe nëngrupi “Materiale elektrike dhe komunikimi” me 0,3 %.

Për më shumë informacion dhe për të parë tabelat e detajuara, vizitoni bazën e të dhënave në faqen zyrtare të INSTAT: [Indeksi i Kushtimit në Ndërtim](#)

Për publikim 04/03/2026

Metodologjia

Indeksi i Kushtimit në Ndërtim (për Banesa) (IKN) duke filluar nga tremujori i parë 2024 do të llogaritet me bazën e re. Tremujori i katërt 2021 do të shërbejë si periudhë bazë për llogaritjen e indeksit (tremujori i katërt 2021 = 100).

IKN mat ecurinë e çmimeve të materialeve të ndërtimit, të fuqisë punëtore dhe të shpenzimeve të tjera kapitale që përdoren në ndërtimin e një banese tip (8 – 10 kate). IKN është një tregues i rëndësishëm ekonomik për sektorin e ndërtimit. Indeksi përdoret si deflator për llogaritjen e Prodhimit të Brendshëm Bruto dhe Indekseve të ndryshme të volumit, përdoret nga Institucionet Qeveritare, Banka Qendrore e Shqipërisë, Organizata të tjera joqeveritare, Banka Botërore, FMN etj. Peshat e shportës së materialeve janë llogaritur duke u bazuar në preventivat e shpenzimeve për ndërtimin e një banese shumëkatëshe marrë nga firmat e ndërtimit. Shporta e re përbëhet nga 71 zëra nga të cilat 66 janë materiale ndërtimi. Çmimet për materialet e ndërtimit mbledhen nga 237 distributorë dhe shitës me shumicë të materialeve të ndërtimit. Ndërsa, të dhënat për shpenzimet për pagat, makineritë dhe transportin merren nga 97 ndërmarrje të mëdha ndërtimi të përqëndruara kryesisht në rrethin e Tiranës. Zgjedhja e ndërmarrjeve është bërë në bazë të volumit të ndërtimit që ato realizojnë gjatë një periudhe një vjeçare. Shpenzimet janë klasifikuar në përputhje me klasifikimin që përdor EUROSTAT për Indeksin e Kushtimit në Ndërtim, në gjashtë grupe kryesore si më poshtë:

- Shpenzime për materiale
- Shpenzime për paga
- Shpenzime për makineri
- Shpenzime transporti
- Shpenzime për energji
- Shpenzime të tjera

Fusha e mbulimit

Indeksi i Kushtimit në Ndërtim përfshin aktivitetin e seksionit F: "Ndërtim" (kodet 41, 42, 43) dhe aktivitetet e Tregtisë me Shumicë të materialeve të ndërtimit: (kodet 46.73, 46.74, 47.52) sipas Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike, Rev.2.

Llogaritja e indeksit

Për llogaritjen e indeksit është përdorur formula e tipit Laspeyres i cili llogaritet sipas formulës:

$$I_0^t = \frac{\sum_k P_{t,k} Q_{0,k}}{\sum_k P_{0,k} Q_{0,k}} = \sum_k \frac{P_{0,k} Q_{0,k}}{\sum_k P_{0,k} Q_{0,k}} \times \frac{P_{t,k}}{P_{0,k}}$$

Rishikimi

Indekset mund të rishikohen për disa arsye: Informacion shtesë, ndryshime metodologjike, ndryshimi i periudhës bazë etj.

Matësit e Indeksit

Ndryshimi vjetor mat ndryshimin e indeksit të çmimeve të tremujorit korrent me të njëjtin tremujor të një viti më parë.

Ndryshimi tremujor mat ndryshimin e indeksit të çmimeve të tremujorit korrent me tremujorin e mëparshëm.